



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI SHTETËROR PËR KULTET

PROJEKT STUDIMOR 1

“MBI MARRËDHËNIET

SHTET – FE

NË NIVEL LOKAL”

(ZONA: SHQIPËRIA VERIORE)

2019

PËRMBAJTJA

- 1) Përmbledhje ekzekutive.
- 2) Hyrje.
- 3) Metodologjia e studimit.
 - 3.1 *Struktura konceptuale.*
 - 3.2 *Qasja kërkimore.*
 - 3.3 *Metoda kërkimore.*
 - 3.4 *Strategjia kërkimore.*
 - 3.5 *Dizenjimi i studimit.*
 - 3.6 *Përpunimi dhe analizimi i të dhënave.*
 - 3.7 *Grafiqet analizuese.*
- 4) Konkluzione.
- 5) Rekomandime.
- 6) Bibliografi.
- 7) Aneksë.

I P Ë R M B L E D H J E E K Z E K U T I V E

Projekti studimor me temë: “*Marrëdhëniet shtet – fe në nivel lokal*”, u ndërmorr me iniciativën e Komitetit Shtetëror për Kultet, nisur nga indiciet e mbledhura në takimet e shumta me përfaqësues të ndryshëm lokalë. Një studim i tillë që bëhet për herë të parë në vendin tonë, drejtohet nga një institucion shtetëror dhe synon të pasqyrojë gjendjen aktuale të marrëdhënieve, pa asnjë influencë me karakter politik apo fetar.

Parë në këndvështrimin e menaxhimit territorial, qëllimi i këtij projekti është:

- krijimi (aty ku nuk ekziston), nxitja dhe forcimi i bashkëpunimit mes aktorëve të ndryshëm shoqërorë, qofshin ata shtetërorë apo fetarë, për zgjidhjen e plagëve sociale, për mbështetjen e të rinjve në nismat për një perspektivë optimiste jete, për ruajtjen dhe promovimin e vlerave historike të bashkëjetesës fetare.
- pasqyrimi i problematikave me të cilat përballen përfaqësuesit e sipërpërmendur, në realitetin lokal, duke përcjellë shqetësimet dhe dëshirat për një përmirësim të situatës ndërrelacionale.
- shkallën e njohurive legislative dhe informacionit në fushën e fesë, si nga përfaqësuesit shtetërorë, ashtu edhe nga ata fetarë, me qëllimin final të mirëinformimit të tyre. Kjo për të siguruar e garantuar ushtrimin e së drejtës së fesë e besimit, si një e drejtë universale, themelore njerëzore.

Projekti është parashikuar të shtrihet në një periudhë kohore trivjeçare (2019-2021), me një shtrirje territoriale që mbulon të gjithë vendin, por të ndarë në tri zona gjeografike:

- Shqipërinë e Veriut (viti 2019),
- Shqipërinë e Jugut (viti 2020),
- Shqipërinë e Mesme (viti 2021).

Kjo ndarje gjeografike dhe kohore është kushtëzuar nga shtrirja e madhe territoriale dhe nga dëshira për t’u thelluar në marrjen e informacionit.

Ai është ndarë në tre faza:

- a) faza përgatitore e pyetësorëve, nëpërmjet të cilëve synohet të merret informacion sa më i besueshëm dhe real;
- b) faza në terren, që përfshin takimet dhe intervistat me përfaqësues lokalë laikë dhe fetarë;
- c) faza përfundimtare, e analizimit të të dhënave, nxjerrjes së konkluzioneve dhe dhënies së rekomandimeve.

Projekti është zhvilluar nëpërmjet një rrjeti kapilar, që ka përfshirë ndarjet administrative nga më të mëdhatë (qarqet, bashkitë, prefekturat) tek më të voglat (njësitë administrative, etj.), për të patur një pasqyrë reale të marrëdhënieve shtet – fe në nivel lokal. Gjatë këtij viti projekti mbulon gjeografikisht pjesën veriore të territorit shqiptar, duke përfshirë qarqet: Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë me 15 bashkitë përkatëse dhe disa njësi administrative.

Marrja e informacionit është realizuar:

Së pari, me zhvillimin e bisedave paraprake me drejtuesit e institucioneve, shtetërore dhe bashkësive fetare.

Së dyti, me zhvillimin e intervistave direkte, “face - to – face”, me punonjësit/klerikët për marrëdhëniet ndërmjet pushtetit lokal dhe bashkësive fetare dhe si mund të përmirësohet më tej kjo marrëdhënie. Intervistat kanë qenë të strukturuar dhe semi - strukturuar, bazuar në pyetësorë të përgatitur paraprakisht me rigozitet nga stafi i Komitetit Shtetëror për Kultet.

Në harkun kohor prej 4 muajsh janë mbuluar 116 njësi administrative dhe intervistuar 178 përfaqësues lokalë.

II) H Y R J E

Marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë (“Fe” - konsideruar si term përgjithësues i një doktrine që beson në një forcë supreme), prej kohësh kanë qenë objekt studimi, duke konsideruar faktin që shpesh kanë modeluar historinë dhe ndikuar në ekuilibrat politikë e kulturorë të shumë vendeve të botës. Këto raporte të ndërsjella kanë pësuar metamorfozë me kalimin e shekujve. Në të kaluarën ishte feja që i jepte shtetit fuqinë dhe autoritetin dhe ndikonte në vendim – marrjet politike e ekonomike. Me ndryshimet legjislative të shumë vendeve demokratike, sidomos gjatë shekullit të XX-të, ku filloi të sundojë veprimi i ligjit, në kushtetutat e shumë prej syresh, u pranua ndarja e shtetit nga feja, me qëllimin për të ruajtur njërin nga influenca e tjetrit dhe anasjelltas. Megjithatë, kjo nuk përjashtonte e nuk përjashtonte faktin që mes shtetit dhe fesë të ketë marrëdhënie për disa arsye:

- 1) E drejta e fesë dhe besimit i përket çdo qytetari, që njëkohësisht është kontribues i shtetit nëpërmjet taksave, prej këtej domosdoshmëria e raporteve shtet – fe.
- 2) Feja është një faktor aktiv në jetën sociale, kulturore, arsimore të një vendi dhe ajo nuk mund të kufizohet në një bindje që i përket vetëm sferës private, si një lloj “Hobby”. Kushtetutat e shumë vendeve demokratike garantojnë shprehjen kolektive dhe publike të besimit, dhe kjo është edhe një çështje që i përket edhe shtetit.
- 3) Ndryshimet demografike, shoqërohen me ndryshime të panoramave kulturore – fetare dhe është detyrë morale e dy palëve të mobilizohen për ruajtjen e ekuilibrave të rinj që krijohen. Mobilizimi nënkupton raporte, të cilat në vendet evropiane, në këtë shekull, lidhen edhe me çështje të sigurisë.

Marrëdhënia midis shtetit dhe fesë ndryshon nga një vend në tjetrin. Qasje të ndryshme shfaqen shesh në kushtetutat e vendeve të ndryshme.

Neni 1 i Kushtetutës Franceze përcakton natyrën laike të shtetit francez.

Klauzola e themelimit në Amendamentin e parë të Kushtetutës së Shteteve të Bashkuara ndalon jo vetëm ekzistencën e një e feje kombëtare, por edhe privilegjimin e një feje ndaj një tjetre nga ana e shtetit.

Neni 140 i Kushtetutës gjermane i referohet disa dispozitave të kushtetutës së Republikës Ëëimar që, nga njëra anë, ndalojnë ekzistencën e një kisha të themeluar, por, nga ana tjetër, përcaktojnë se emërtimet fetare mund të njihen nga shteti.

Në Angli, natyrisht Kisha Anglikane është kisha themeluese e pranuar.

Në Hollandë, ndarja e kishës dhe shtetit supozohet të jetë një parim i pashkruar i ligjit kushtetues, pasi Ligji Themelor hesht për këtë çështje.

Legjislacioni dhe praktika gjyqësore shtjellojnë marrëdhëniet midis shtetit dhe fesë në vende të ndryshme. Si rezultat, lind një pamje shumë e komplikuar. Prandaj, studimet juridike krahasuese shpesh përdorin modele.

Winfried Brugger (profesor i ligjit dhe filozofisë në Heidelberg-Gjermani), në studimet e tij, veçon 6 modele të ndryshme të marrëdhënieve shtet-fe:

a) Në të parin shteti është plotësisht kundër fesë, siç ishte rasti i vendit tonë, ku në vitet shtatëdhjetë dhe tetëdhjetë të shekullit të kaluar, feja u ndalua zyrtarisht, mund të ketë qenë një shembull.

b) Modeli i dytë karakterizohet nga një “mur i ndarjes”, i marrë seriozisht jo vetëm në teori, por edhe në praktikë. Ndalimi i të gjitha shenjave fetare nga arsimi publik i përket këtu modelit francez.

c) Modeli i tretë është më pak drastik: “ndarja” dhe “lejimi” janë të lidhura. Qeveria nuk mund as të përparojë dhe as të pengojë fenë.

d) Modeli i katërt ndërthur ndarjen me një lloj bashkëpunimi. Gjermania, ku qeveria, për shembull, kujdeset për mbledhjen e “taksës së kishës” për emërtimet fetare të njohura, mund të shërbejë si një shembull i këtij modeli.

e) Modeli i pestë karakterizohet nga një unitet më zyrtar i shtetit dhe kishës në formën e një kishe themeluese, të vendosur. Shteti dhe kisha kanë akoma qëllime të ndryshme; respektivisht, mirëqenia e qytetarit dhe shpëtimi i tij. Ky model shkakton shqetësim, të paktën, sepse një kishë e krijuar mund të ketë të gjitha llojet e përparësive dhe privilegjeve në krahasim me emërtimet e tjera besimore.

f) Në modelin e fundit, ku ndryshimi është zhdukur, shteti dhe kisha konvergojnë në të vërtetë në një teokraci.

Marrëdhëniet mes shtetit dhe fesë kanë karakterizuar edhe realitetin historik shqiptar. Megjithëse studimet në këtë fushë, nuk janë të shumta, marrëdhëniet reciproke mund të cilësohen bashkëpunuese, sidomos kur është bërë fjalë për fatet e kombit. Ndërsa, përsa i përket atyre në nivelin social, Shqipëria duket se nuk ka patur ndonjë traditë të mirëfilltë. Ligji i Mbretit Zog mbi fenë, i vitit 1929, siguronte të drejtën e besimit, por vendoste në zgjedhjen e klerëve fetarë dhe iu ndalonte klerikëve në detyrë, të drejtën e votimit në zgjedhjet politike.

Në vitet 1990 Shqipëria nuk kishte një organizim institucional që rregullon marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare të rilindura. Pas dekadash të shtypjes komuniste, elita politike dhe komunitetet fetare ndjenë nevojën e zgjerimit dhe vendosjes së organeve që sigurojnë lirinë fetare (Elbasani, 2016). Opozita e parë politike premtoi të vendosë “lirinë e takimit, lirinë e shtypit, të besimit dhe ushtrimit të tij”. Parlamenti i parë pluralist i vitit 1991 siguroi “lirinë fetare dhe krijimin e kushteve për ushtrimin e tij”. Pavarësisht gjithë përpjekjeve mund të thuhet se rregullimi formal i aktiviteteve fetare mori pothuajse një dekadë për t’u përmbushur. Në mungesë të bazës ligjore të saktë marrëdhëniet midis shtetit dhe komuniteteve fetare ishin vendosur *ad hoc* dhe në mirëbesim të dy anshëm. Si fillim në vitin 1992 insitucioni i vetëm në funksion të administrimit të marrëdhënieve fetare ishte Sekretariati i Shtetit, megjithëse duhet

theksuar se organizimi ishte i vakët (Elbasani, 2016). Rreth vitit 1998 ishte e kuptueshme qartësisht që marrëdhëniet nuk mund të ecnin me mirëbesim pasi palët ishin të ndjeshme dhe çështjet mund të agravoheshin nga momenti në moment. Për këtë arsye u ndie nevoja e formalizimit të marrëdhënieve. Autoritet mbikëqyrëse filluan formalizimin e një strukture rregullatore të përshtatshme, përse u përket të drejtave dhe detyrimeve të komuniteteve fetare dhe marrëdhënia e tyre me shtetin. Në vitin 1998, Kushtetuta elaboroi në mënyrë të detajuar kushtet e ndarjes, kontrollit dhe bashkëpunimit midis shtetit dhe organizatave fetare (Puto, 2015).

Shtetit i atribuohet roli kryesor i përcaktuesit dhe ruajtësit të “të mirës së secilit dhe të të gjithëve”. Kushtetuta i vlerëson organizatat fetare me statusin e “personit juridik” dhe ato duhet të regjistrohen në Gjykatën e Tiranës e cila verifikon përshtatshmërinë e tyre me legjislacionin e shtetit. Në linjë me rolin e shtetit, statuti i Komitetit Shtetëror për Kultet gjithashtu përshkruan se ai duhet të drejtohet nga një kryetar neutral dhe të respektojë statutin (Këshilli i Ministrave, 1999).

Ndërkohë, shteti nga ana e tij, është ndërgjegjësuar vazhdimisht për forcimin e së drejtës së ushtrimit të fesë duke përmirësuar legjislacionin në këtë fushë e duke iu përmbajtur konventave ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut. Përveç kësaj, ngritja dhe funksionimi i institucioneve shtetërore garantuere e rregullatore të këtyre të drejtave, dëshmon vëmendjen dhe rëndësinë me të cilat qeveria shqiptare trajton këto të drejta.

Komiteti Shtetëror për Kultet duke ruajtur të njëjtën strukturë me Sekretariat Shtetëror për Fenë, kalon pranë Këshillit të Ministrave, deri në miratimin e Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) Nr. 459, datë 23.09.1999. Ai është institucion shtetëror qendror që mbulon marrëdhëniet ndërmjet Shtetit dhe bashkësive fetare. Komiteti Shtetëror për Kultet ka pasur dhe ka si përparësi të veprimtarisë së vet, punën për zbatimin e detyrimeve të tij kushtetuese, plotësimin e kuadrit ligjor mbi marrëdhëniet e Shtetit me fenë, ruajtjen dhe zhvillimin e harmonisë ndërfetare në vend.

Aktualisht panorama multikonfesionale në vendin tonë përmbledh 5 bashkësi fetare, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Kisha Ortodokse Autoqefale, Kisha Katolike në Shqipëri, Kryegjyshata Botërore Bektashiane dhe Vëllazëria Ungjillore e Shqipërisë, që i përkasin traditës shqiptare të fesë dhe që kanë lidhur marrëveshje me Këshillin e Ministrave dhe rreth 4 besime të tjera, të reja për realitetin tradicional shqiptar. Të gjitha gëzojnë dhe ushtrojnë lirisht të drejtën e fesë, si shprehje e zbatimit të neneve 10, 18 dhe 24 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Sot, në vendin tonë numërohen rreth ----- klerikë, rreth ----- shkolla, rreth 3000 objekte kulturi.


III) METODOLOGJIA E STUDIMIT

Një studim i tillë, që realizohet për herë të parë nga një institucion shtetëror, synon të pasqyrojë gjendjen aktuale të marrëdhënieve mes pushtetit vendor dhe bashkësive/shoqatave/besimeve fetare lokale, pa patur asnjë influencë me karakter politik apo fetar. Ai është konceptuar nisur nga indikatorët sinjalizues të mbledhur në eksperiencën shumëvjeçare të Komitetit. Parimi bazë është ai i misionit të përbashkët final të të dy palëve: shtet – fe, i cili është rezultat i një pune të përbashkët mes tyre.

Studimi mbulon gjeografikisht pjesën veriore të territorit shqiptar, duke përfshirë qarqet: Shkodër, Kukës, Dibër, Lezhë me 15 bashkitë përkatëse dhe disa njësi administrative.

3.1 Struktura konceptuale

Nisur nga sa mësipër, dhe në zbatim të detyrave të tij ligjore, Komiteti ndërmerr këtë projekt konstatimi/studimi, për të analizuar realitetin e marrëdhënieve mes pushtetit dhe feve/besimeve në nivel lokal, konceptuar sipas skemës së mëposhtme.



3.2 Qasja kërkimore

Rregullimi i i marrëdhënieve midis shtetit dhe fesë, midis individit dhe autoriteteve fetare dhe midis ligjeve laike dhe kodeve fetare historikisht kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë një nga funksionet e kushtetutës. Por, marrëdhënia shtet-fe vazhdon të jetë një ndër çështjet më të vështira për kushtetuesit në mbarë botën. Problemet që mund të lindin në këtë kontekst janë specifike sipas rastit, por që përgjithësimet e caktuara mund të bëhen ku, ndër to mund të përmenden: bashkëngjitja e një feje të caktuar identitetit të shtetit apo mbushja e opinionit publik me palë që motivohen apo identifikohen me një fe të caktuar. Në këto dhe në të tjera kushte lind

nevoja e trajtimit të fesë me status kushtetues të vecantë. Por duke qenë së çështje të tilla kanë ndjeshmëri të lartë, përfshijnë një sërë principesh dhe identitetesh personale, diskutimi i një marrëdhënie të tillë duhet të ngrihet në mënyrë shumë të kujdesshme duke marrë parasysh kontekstin dhe duke u bazuar tek rrethanat politike, historike dhe kulturore.

Marrëdhëniet shtet-fe mund të ndërtohen në mënyra të ndryshme bazuar në:

a) shtrirjen në të cilën shteti financon, mbështet apo miraton fenë, ose njeh një bazë fetare ndaj shtetit apo ndaj autoritetit publik;

b) shtrirjen në të cilën ligjet apo institucionet fetare kontrollojnë apo influencojnë shtetin.

Pavarësisht kategorizimit ndaj të cilit nuk mund të ketë një terminologji standarde, qasjet kryesore mund të përcaktohen si:

a) marrëdhënie laike apo laicitet i fortë,

b) neutralitet apo laicitet i dobët,

c) vendosje pluraliste,

d) njohje,

e) establishment i dobët,

f) establishment i fortë.

Këto janë lloje që njihen kryesisht si mënyra bashkëveprimi, por ndërtimi i marrëdhënieve shtet-fe kërkon një kuptueshmëri shumë të gjerë të shumë elementëve përbërës. Si fillim merret parasysh përbërja demografike e fesë, përmes së cilës kuptojmë që procesi i ndërtimit kushtetues ndodh në një vendndodhje specifike që ka historinë, kulturën dhe identitetin e tij fetar. Ndaj dhe demografia merr rëndësi në këtë pikë, pasi në shtetet ku ka një grup dominant fetar, ku anëtarësimi i atij besimi historikisht lidhet ngushtë me identitetin kombëtar, mund të ndodhë që i jepet një status një besimi që reflekton një konsensus të gjerë social. Për shumë njerëz, ndjenjat fetare, përkatësitë dhe besimet janë pjesë integrale e identitetit të tyre dhe ndjeshmëria me të cilën shoqërohen këto ëështje duhet të konsiderohen nga shteti në përpjekjet e tyre për të gjetur kompromise midis grupeve të ndryshme brenda të njëjtit besim apo besimeve të ndryshme. Por, nuk duhet harruar gjithashtu se identiteti fetar është një çështje e besimit personal, apo e thënë ndryshe, një zgjedhje individuale, ku besime të ndryshme dhe grupe të ndryshme të të njëjtit besim kanë qasje të ndryshme ndaj këtyre çështjeve, për këtë arsye i ngel shtetit t'i konsiderojë ata në ndërtimin e tij. Mbi të gjitha ajo që duhet të prevalojë në kohët moderne është demokracia, ndaj dhe çfarëdo lloj marrëdhënie e krijuar kërkon që pikë së pari të siguroj demokraci të plotë për individët. Së fundmi element i rëndësishëm i marrëdhënies midis shteti dhe fesë është forma hierarkike dhe përfaqësimi. Disa fe janë hierarkike, me ndarje të ndryshme, ndërkohë të tjera nuk kanë ndarje formale, duke ju dhënë rëndësi studiuesve fetarë, praktikuesve apo drejtuesve të

tjerë. Në këtë pikë merr rol të veçantë shteti si rregullator i të gjitha çështjeve që lidhen me organizimin struktural të insitucioneve fetare. Shteti duhet të kuptojë natyrën e besimit dhe kërkesat e tij, çfarë duan liderët fetarë dhe pse, deri në çfarë pike udhëheqësit fetarë përfaqësojnë komunitetet apo individët e thjeshtë, etj.

Qëllimi i këtij studimi është që, pasi të mbledhë të dhëna të mjaftueshme dhe të besueshme mbi nivelin e marrëdhënieve interaktive mes pushtetit vendor dhe bashkësive/ shoqatave fetare lokale, të propozojë mënyrat, rrugët, mjetet dhe aktorët e duhur për përmirësimin e mëtejshëm të tyre, në shërbim të komuniteteve lokale. Mbështetur në mungesën e studimeve të tilla të mëparshme, ky studim nuk mund të paraqesë trendin e marrëdhënieve pushtet vendor – fe, krahasuar me të kaluarën, por do të shërbejë si një pikënisje për studime të ngjashme në këtë fushë.

3.3 Metoda kërkimore

Ky studim bazohet në intervistat e marra duke zbatuar metodën e kontaktit të drejtpërdrejtë. Të intervistuarit janë punonjës të pushtetit vendor (bashkive, qarqeve etj.), të bashkësive dhe shoqatave fetare (kler, personel laik). Ata i përkasin gjinive të ndryshme, fashave të ndryshme të moshës dhe niveleve të ndryshme të arsimimit. Duke qenë se nuk ekziston një background studimor në këtë fushë, jemi munduar që të vendosim kriteret e përzgjedhjes së të intervistuarve, procesit në terren, konform specifikës së realitetit shqiptar. Intervistat janë të strukturuar dhe gjysëm të strukturuar, ndërtuar si një kombinim i metodës me përgjigje të hapura, të pasuruara me komente nga të intervistuarit dhe asaj me përgjigje të zgjedhjeve të shumëfishta.

3.4 Strategjia kërkimore

Studimi bazohet në një strategji cilësore, përshkruese dhe interpretuese, ku, pavarësisht hipotezave të mundshme që mund të paraqiten, i është përmbajtur besnikërisht perceptimit të marrëdhënieve në nivel lokal. Interpretimi i të dhënave të mbledhura, jep panoramën reale dhe për rrjedhojë, edhe rekomandimet e rastit. Përzgjedhja e strategjisë i është përshtatur tematikës dhe qëllimit, ku çdo i intervistuar pasqyron këndvështrimin e tij, subjektiv apo objektiv, të marrëdhënieve pushtet vendor – fe.

3.5 Dizenjimi i studimit

Nisur nga qëllimi i realizimit të këtij projekti, gjatë gjithë procesit kërkimor, do të merren parasysh faktorët subjektivë që ndikojnë të intervistuarit. Ky element përbën njëfarë risku/gabimi të ndreqshëm në procesin përfundimtar të vlerësimit. Nisur nga fakti logjik se, ky projekt nuk është konceptuar të furnizojë shifra, rezultati pritet të reflektojë një trend, pozitiv apo negativ, sipas të cilit duhet vepruar në vijim. I gjithë projekti është parashikuar të mbulohet me shpenzimet institucionale, të pasqyruara në PBA 2019-2021.

3.6 Përpunimi dhe analizimi i të dhënave dhe Grafiket analizuese

Në këtë pjesë të studimit, paraqiten në mënyrë të detajuar shpërndarjet e frekuencave të subjektit pjesëmarrës në pyetësorë.

Siç nënkuptohet edhe nga emërtimi, analiza përshkruese përdoret për të përshkruar të dhënat e mbledhura në studimet kërkimore dhe për të karakterizuar me saktësi çështjet e survejuara brenda një kampioni specifik.

Analizat përshkruese përdoren shpesh për të përmbledhur një kampion studimi. Kjo, sepse luan një rol të rëndësishëm për sigurimin e informacionit paraprak për përfaqësimin e përgjithshëm të kampionit të studimit, si dhe informacionin e nevojshëm që do të shërbejë për studime tjera të mundshme në të ardhmen. Në përpjekjet e ndryshme kërkimore, sikurse mund të jenë thjesht studime përshkruese, përshkrimi i saktë dhe gjithëpërfshirës i të dhënave të studimit mund të jenë edhe fokusi kryesor i studimit. Në të dy rastet, qëllimi kryesor i analizës përshkruese është që të paraqesë me saktësi shpërndarjen e vlerësimeve të bëra për çështje brenda një grupi të veçantë të të dhënave.

Ekzistojnë një larmi metodash për të ekzaminuar shpërndarjen e një ndryshoreje. Ndoshta metoda më themelore dhe pika fillestare, pothuajse baza e të gjithë analizave statistikore, është shpërndarja e frekuencës.

Analiza e frekuencës është një hap i rëndësishëm që duhet të ndërmerret në fillim të përpunimit dhe analizimit të të dhënave dhe realizohen nëpërmjet përgatitjes së tabelave të shpërndarjes ose frekuencës. Qëllimi dhe ideja e përgatitjes së tabelave të frekuencave është që të tregojë vlerësimin e bërë nga subjekti pjesëmarrës në studim, për secilën variabël. Me "frekuencë" nënkuptohet numri i herëve kur ndodh diçka. Pra, jepet llogaritja e përqindjeve, të cilat na tregojnë përqindjen e rasteve që përmbahen brenda secilës frekuencë. Pra, me nocionin 'frekuencë' nënkuptojmë thjesht një numër që na tregon se sa shpesh ndodh diçka në të dhënat e siguruar, dhe i referohet numrit të vlerës së shfaqur në një kategori të një ndryshoreje dhe rezultateve të sasisë ose masës së një ndryshoreje. Analiza e frekuencës përdoret për të përkufizuar rastin se sa shpesh ndodh diçka në një periudhë kohore të caktuar.

Më poshtë, paraqitet shpërndarja e frekuencave për secilën variabël sipas radhës.

Si fillim, sqarojmë se kampioni pjesëmarrës në këtë studim përbëhet nga gjithsej 178 pjesëmarrës, përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe njërive lokale të bashkësive fetare apo dhe shoqatave/fondacioneve fetare, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në rajonin e Veriut të Shqipërisë.


1. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas vendbanimeve

Sikurse është paraqitur edhe në grafikun e mëposhtëm, nga gjithsej 178 pjesëmarrës të cilët kanë pranuar të bëhen pjesë e studimit duke plotësuar pyetësorët, më së shumti, janë nga qyteti i Shkodrës, Matit, Kukësit, Lezhës dhe Peshkopisë.

Përkatësisht, rezulton se, 14 % (n=25) e pjesëmarrësve janë nga Shkodra, 11.8 % (n=21) nga Kukësi, 10.7 % (n= 19) nga Mati, 9.0 % (n= 16) nga Lezha, 9.0 % (n=16) nga Peshkopia, 7.9 %

(n= 14) nga Tropoja, 6.2 % (n= 11) nga Hasi, 5.6 % (n= 10) nga Bulqiza, 5.1 % (n= 9) nga Puka, 5.1 % (n= 9) nga Mirdita, 4.5 % (n= 8) nga Vau i Dejës, 4.5 % (n= 8) nga Malësia e Madhe, 2.2 % (n= 4) nga Fushë Arrësi, 2.2 % (n= 4) nga Kurbini dhe 2.2 % (n= 4) nga Klosi.


Grafiku 1: Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas qyteteve



2. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas gjinisë

Përsa i përket gjinisë së pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 87.1 % (n=155) janë meshkuj dhe 12.9% (n=23) janë femra.


Grafiku 2: Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas gjinisë



3. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave

Nga ana tjetër, vërejmë se shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshave është: 37.1 % (n= 66) i përkasin grupmoshës 46-55 vjeç, 28.7 % (n= 51) grupmoshës 36-45 vjeç, 16.3 % (n= 29) grupmoshës 25-35 vjeç, 14.0 % (n= 25) grupmoshës 56-65 vjeç dhe, 3.9 % (n= 7) i përkasin grupmoshës mbi 65 vjeç.


Grafiku 3: Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas grupmoshës



4. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas nivelit të arsimit

Po ashtu, sa i përket nivelit të arsimit të pjesëmarrësve në këtë studim, rezulton se, 56.2 % (n= 100) e tyre kanë kryer arsimin e lartë laik, 16.9 % (n= 30) arsimin e mesëm laik, 16.3 % (n= 29) arsim të lartë fetar, 5.6 % (n= 10) arsim të mesëm fetar, 3.9 % (n= 7) arsim profesional laik dhe, 1.1 % (n= 2) kanë kryer arsim profesional fetar.


Grafiku 4: Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas nivelit të arsimit



5. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas llojit të institucioneve që përfaqësojnë

Sipas të dhënave të paraqitura në grafikun e mëposhtëm, rezulton se, 68.5 % (n= 122) e pjesëmarrësve përfaqësojnë institucione lokale shtetërore, 30.3 % (n= 54) e tyre përfaqësojnë institucione lokale të bashkësive fetare dhe, 1.1 % (n= 2) e tyre përfaqësojnë shoqata ose fondacionet fetare.


Grafiku 5: Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas llojit të institucionit që përfaqësojnë



6. Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas vjetërsisë në detyrë

Sa i përket përvojës në detyrën aktuale që ushtrojnë, rezulton se 37.6 % (67) e pjesëmarrësve kanë përvojë 3-5 vite, 31.5 % (n= 56) mbi 5 vite, 19.7 % (n= 35) e tyre kanë 1-3 vite dhe, 11.2 % (n= 20) kanë më pak se 1 vit përvojë në detyrën që ushtrojnë.

Grafiku 6: Shpërndarja e pjesëmarrësve sipas vjetërsisë në detyrë



7. Statistikat përshkruese për nivelin e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta, marrëveshjet e nënshkruara midis shtetit dhe bashkësive fetare dhe Ligjit për OJF-të

Tabela 1: Statistikat përshkruese				
	N	Mini.	Maks.	Mesatarja
Sa njohuri keni mbi të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë?	177	1	3	1.84
Sa njohuri keni mbi marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare në vend?	177	1	3	2.04
Sa njohuri keni mbi Ligjin Nr. 8788, dt. 07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse'?	174	1	3	2.12
Valid N (listëse)	173			

Si fillim, sqarojmë se, për pyetjet e paraqitura në tabelën 1, matjet janë realizuar me anë të shkallës Likert me tre pikë: (1- Dobët, 2 - Mirë, 3 - Shumë mirë).

Nga rezultatet e arritura, rezulton se, për pyetjen e parë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, rezulton se, është arritur një mesatare prej 1.84 pikë nga maksimalja e mundshme që ishte 3.

Për pyetjen e dytë, e cila kishte për qëllim matjen e njohurive të pjesëmarrësve për marrëveshjet e nënshkruara midis Shtetit dhe bashkësive fetare, rezulton se mesatarja e përfutur është 2.04 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.

Ndërsa, për pyetjen e tretë, e cila synon të masë nivelin e njohurive të pjesëmarrësve për Ligjin Nr. 8788, dt.07.05.2001 'Për Organizatat Jofitimprurëse', nëpërmjet të cilit rregullohet aktiviteti i shoqatave dhe fondacioneve me karakter fetar që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend, rezulton se, mesatarja e përfutur është 2.12 nga 3 që ishte maksimalja e mundshme.

Ndër të tjera, për të pasur të dhëna më të detajuara me qëllim analizimin e mëtejshën në rang qytetesh, më poshtë, në tabelën 1.1 janë paraqitur rezultatet e këtyre njohurive në rang qytetesh.

7.1. Statistikat përshkruese për nivelin e njohurive të pjesëmarrësve në lidhje me të drejtat fetare të garantuara nga Kushtetuta, marrëveshjet e nënshkruara midis shtetit dhe bashkësive fetare dhe Ligjit për OJF-të (sipas qyteteve)

Tabela 1.1: Statistikat përshkruese sipas qyteteve	Niveli i njohurive për të drejtat Kushtetuese			Niveli i njohurive për marrëveshjet			Niveli i njohurive për Ligjin Nr. 8788, 'Për OJF		
	Min.	Maks.	Mesatarja	Min.	Maks.	Mesatarja	Min.	Maks.	Mesatarja
Shkodër	1	3	2	1	3	2	1	3	2
Pukë	1	2	1	1	2	1	1	2	2
Fushë- Arrëz	1	2	2	2	2	2	1	2	2
Vau Dejës	1	3	2	1	3	2	1	3	2
Malësi e Madhe	1	2	2	1	3	2	1	2	2
Kukës	1	3	2	1	3	2	2	3	3
Tropojë	1	2	2	1	3	2	1	2	2
Has	2	3	2	1	3	2	2	3	2
Lezhë	1	2	2	1	2	2	1	3	2
Mirditë	1	2	2	1	3	2	1	2	2
Kurbin	1	2	2	2	2	2	1	2	2
Peshkopi	1	2	2	1	3	2	1	3	2
Mat	2	3	2	1	3	2	2	3	2
Klos	1	2	2	2	2	2	1	2	2
Bulqizë	1	3	2	1	3	2	1	3	2

8. Njohuritë e pjesëmarrësve për numrin e bashkësive fetare në Shqipëri

Në tabelën 2 paraqiten të dhënat statistikore përshkruese për njohuritë që ka subjekti pjesëmarrës në lidhje me numrin e bashkësive fetare të pranishme në Shqipëri.

Nga rezultatet e arritura, vërejmë se, 59.0 % (n= 105) e pjesëmarrësve raportojnë për praninë e pesë bashkësive fetare, 30.3 % (n= 54) për katër, 6.7 % (n= 12) për tre, 2.2 % (n= 4) për gjashtë, 1.1 % (n= 2) shprehen se nuk e dinë dhe, 0.6 % (n = 1) e subjektit pjesëmarrës raporton për praninë e dy bashkësive fetare të pranishme në vend.

Tabela 2: Shpërndarja të dhënave në lidhje me njohuritë për numrin e bashkësive fetare

	Frekuenca	%
2	1	0.6
3	12	6.7
4	54	30.3
5	105	59.0


6	4	2.2
Nuk e di	2	1.1
Total	178	100.0

9. Shpërndarja e të dhënave për perceptimin e marrëdhënieve midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve të bashkësive fetare në nivel lokal

Perceptimi i marrëdhënieve midis institucioneve shtetërore dhe bashkësive fetare në nivel lokal, u mat në formë kategorike, bazuar në tre nivele: *bashkëpunuese*, *kortezie* dhe *dobët*, alternativa të cilat u koduan me 1,2,3 sipas radhës.


Sikurse vërehet edhe në Grafikon 7 dhe 8 të paraqitur mëposhtë, në të cilën paraqiten të dhënat e frekuencave për secilin drejtim të marrëdhënieve midis institucioneve, rezulton se, marrëdhëniet me drejtim *'institucione shtetërore – institucione të bashkësive fetare'* janë vlerësuar në masën 91.53 % (n= 162), si marrëdhënie bashkëpunuese.

Grafiku 7: Perceptimi i marrëdhënieve instucione shtetërore - institucione fetare



Ndërsa, në marrëdhënien me drejtim *'institucione të bashkësive fetare – institucione shtetërore'* janë vlerësuar në masën 93.8 % (n= 166) si marrëdhënie bashkëpunuese.

Grafiku 8: Perceptimi i marrëdhënieve institucione fetare - instucione shtetërore




10. Shpërndarja e frekuencave të takimeve midis institucioneve shtetërore dhe institucioneve fetare në nivel lokal

Sa i takon shpeshësisë së takimeve të realizuara midis institucioneve shtetërore dhe atyre fetare në nivel lokal, rezulton se, mesatarisht, realizohen 2.96 takime në vit.


<i>Tabela 3: Statistikat përshkruese për takimet vjetore midis institucioneve</i>				
	N	Min.	Maks.	Mesatarja
Sa është numri i takimeve të realizuara mes institucioneve shtetërore dhe bashkësive lokale fetare në vit?	174	1	5	2.96
Valid N (listëise)	174			

Grafiku 9: Frekuenca e takimeve vjetore midis institucioneve shtetërore dhe bashkësive fetare në nivel lokal




11. Shpërndarja e frekuencave për problematikat e ngritura nga bashkësitë fetare lokale dhe atyre të zgjidhura nga institucionet shtetërore lokale

Në një përmbledhje të përgjithshme të përgjigjeve të subjektit pjesëmarrës për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore, rezulton se, 40.4 % (n= 72) e tyre raportojnë 0-2 çështje, ndërsa, 29.2 % (n=52) nuk raportojnë të jenë ngritur problematika, duke arritur kështu një mesatare prej 2.22 pikësh për numrin e problematikave të ngritura në drejtim të institucioneve shtetërore lokale.



Ndërsa, përsa i përket zgjidhjes së problematikave të ngritura, subjekti pjesëmarrës raporton në masën 47.2 % (n= 84) se janë zgjidhur nga 0-2 prej tyre, duke arritur kështu, një mesatare prej 1.96 pikësh.



12. Shpërndarja e frekuencave për diskriminimin dhe favorizimin

Përsa i përket çështjes së pranisë së praktikave diskriminuese në marrëdhëniet midis institucioneve shtetërore dhe atyre të bashkësive fetare në nivel lokal, rezulton se subjekti pjesëmarrës ka raportuar në masën 82.6 % (147) negativisht dhe 8.4 % (n= 15) pozitivisht. Ndërsa, 9.0 % (n= 16) shfaqet si vlerë e humbur, që nënkupton se subjekti pjesëmarrës ka refuzuar të përgjigjet.

Tabela 4: Shpërndarja e frekuencave për perceptimin e diskriminimit në marrëdhënien shtet-fe në nivel lokal

		n	%
Valid	Po	15	8.4
	Jo	147	82.6
	Total	162	91.0
Missing	System	16	9.0
Total		178	100.0

Nga ana tjetër, po ashtu, subjekti pjesëmarrës raporton në masën 89.3 % (n= 159) negativisht në lidhje me ekzistencën e praktikave favorizuese midis palëve. Ndërsa, 9.0 % (n= 16) e tyre, raportojnë pozitivisht.

Tabela 5: Shpërndarja e të dhënave për perceptimin e favorizimeve në marrëdhënien shtet-fe në nivel lokal

		n	%
Valid	Po	16	9.0
	Jo	159	89.3
	Total	175	98.3
Missing	System	3	1.7
Total		178	100.0

IV) KONKLUSIONE

Rezultatet e kësaj analize tregojnë se, ndër pjesëmarrësit që kanë plotësuar pyetësonin, ka një dominancë të dukshme të meshkujve krahasuar me femrat. Numrin më të madh të të intervistuarve e regjistron qyteti i Shkodrës, ndërsa më të voglin qytetet e Fushë-Arrëzit, Laçit dhe Klosit. Sa i përket pjesëmarrjes së shtresave shoqërore, shihet se mbizotërojnë përfaqësuesit e institucioneve shtetërore, gjë që gjen shpjegim jo vetëm për nga forma organizative e bashkësive fetare/shoqatave, por edhe nga mënyra me të cilën ata punojnë. Grupmosha më e spikatur është 46-55 vjeç, ndërsa nga pikëpamja e nivelit arsimor shihet se mbizotërojnë individët me arsim të lartë laik. Një pjesë e vogël e kësaj grupmoshe është me arsim të mesëm laik, e cila përbën kryesisht pjesën e administratës vendore të zonave rurale.

Lëvizjet e shpeshta të punonjësve të administratës shtetërore ndikojnë në dobësimin e marrëdhënieve ndërmjet pushtetit vendor dhe bashkësive/shoqatave fetare, pasi pjesa më e madhe e të intervistuarve kishin një periudhë të shkurtër përvojë në detyrën që ushtronin, e cila varionte nga 3 deri në 5 vjet. Konsolidimi i strukturave të administratës vendore krijon qëndrueshmëri edhe në marrëdhëniet ndërmjet palëve.

Njohuritë mbi bazën ligjore nuk mishëronin nivelin më të lartë të pritshmërive, gjë që reflektohet jo vetëm te punonjësit e administratës, por edhe te përfaqësuesit e bashkësive fetare. Kishte mungesa të theksuara të njohjes së Kushtetutës, të marrëveshjeve të nënshkruara ndërmjet shtetit dhe bashkësive fetare, si dhe të ligjit nr. 8788, dt. 07.05.2011 “Për Organizatat Jofitimprurëse”, mungesa të cilat nuk të ishin kaq të dukshme, pasi baza ligjore konsiderohet se njihet mirë nga të dyja palët që operojnë në çështjet fetare.

Përveç sa më sipër, gjatë plotësimit të pyetësonit u vu re se, përfaqësuesit e institucioneve vendore/shoqatave/bashkësive fetare, nuk kishin informacionet e nevojshme as mbi funksionin dhe rolin që luan Komitetit Shtetëror për Kultet, si institucioni shtetëror që bashkërendon marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe fesë.

Po ashtu, pushteti vendor dhe bashkësitë fetare rezultojnë të mos kenë njohuri të sakta as mbi numrin e shoqatave/bashkësive fetare që veprojnë në zonën e tyre, megjithëse bashkëpunimi ndërmjet të dyja palëve ka qenë në nivelin e duhur. Për këtë arsye, shihet e rekomandueshme që ata të jenë më shumë të interesuar dhe të vlerësojnë në mënyrën e duhur shërbimet që ofron secila palë. Mbi të gjitha, ky bashkëpunim nuk duhet kufizuar vetëm te rastet e festave apo të nevojave të ndryshme të secilës palë, përkundrazi, veprimtaria e tyre duhet ndërthurur e zgjeruar

gjer tek elemente që prekin drejtpërdrejt problemet e përditshme të qytetarëve, duke kontribuar kështu edhe në përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre. Institucionet shtetërore duhet t'i ftojné përfaqësuesit e bashkësive/shoqatave fetare në takimet që ata zhvillojnë dhe t'i shndërrojnë këta të fundit në aktorë, duke e vendosur fokusin te komuniteti ku jetojnë.

Numri i problemeve të adresuara nga shoqatat/bashkësitë fetare rezulton të jetë jo shumë i lartë. Në më të shumtën e herëve ato kanë gjetur në të vërtetë një zgjidhje, por institucionet shtetërore duhet t'i trajtojnë raste të tilla më me përparësi dhe në kohën e duhur. Trajtimi me seriozitetin e duhur i këtyre çështjeve nga organet e pushtetit vendor do të çojë në shmangien e radhëve të gjata nëpër dyer administratash.

Shumë pozitiv është fakti që bashkësitë fetare/shoqatat nuk ndihen të diskriminuara e as të favorizuara nga institucionet shtetërore. Përfaqësuesit e bashkësive fetare/shoqatave shprehen se funksioni që ata ushtrojnë nuk ka ndikuar që të shihen "me sy tjetër", por as të marrin ndonjë trajtim të veçantë.

V) REKOMANDIME

Nisur nga sa më sipër, Komiteti Shtetëror për Kultet rekomandon që:

- 1) Të përgatitet një doracak/manual, ku të përfshihen Kushtetuta e Shqipërisë, marrëveshjet e nënshkruara me bashkësitë fetare, ligji për OJF-të, baza ligjore e Komitetit Shtetëror për Kultet etj.. Kjo do të kontribuojë në një njohje më të mirë të legjislacionit dhe të institucioneve shtetërore, si dhe në forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve ndër-institucionale.
- 2) Në institucionet shtetërore sugjerojmë të ketë një punonjës të posaçëm, i cili të merret me trajtimin e çështjeve fetare, por dhe të shërbejë si pikë kontakti me Komitetin Shtetëror për Kultet.
- 3) Gjatë intervistimit, u pa e arsyeshme që disa nga pyetjet e pyetësorit të pasuroheshin me qëllim rritjen e besueshmërisë së intervistave dhe marrjen e një informacioni më të thellë e më të saktë të temës që trajtohet, por jo duke u larguar nga thelbi i tij.
- 4) Për Projektin nr. 2, që do të përfshijë Shqipërinë e Jugut dhe do të ekzekutohet gjatë vitit 2020 nga KSHK, marrja e të dhënave të bëhet në sistem kapilar, deri në njësitë më të vogla administrative. Kjo do të jete një shtysë për përmirësimin e përpjekjeve institucionale në forcimin e bashkëpunimit në nivel vendor.

VI) BIBLIOGRAFI

VII) ANEKSE